

Akti i Themelimit i
“Tirana Institute of Technology” SH.P.K.

Në mbështetje të legjislacionit shqiptarë, në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në dokument referuar si "Ligji", hartohet Akti i Themelimit, me kushtet që përçaktohen si më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **Tirana Institute of Technology**, në vijim referuar si "Shoqëria" themelohet sipas formës dhe kuptimit të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pjesa IV – Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe në përputhje të plotë me Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Emërtimi

Shoqëria quhet **Tirana Institute of Technology**, shkurtimisht **TiranaIT**.

Neni 3

Sigla (Logo)

Forma dhe përmbajtja e siglës (logos) përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë.

Neni 4

Vula

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë. Vula figuron në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del prej shoqërisë. Vula mbahet dhe administrohet nga Drejtori Ekzekutiv.

A handwritten signature in black ink, consisting of several overlapping loops and lines, positioned in the bottom right corner of the page.

Neni 5

Selia

Selia është në adresën: Rruga "Qemal Stafa", godina 2, hyrja 3, njesia 17, Tiranë, Shqipëri. Kjo adresë mund të ndryshojë në varësi të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6

Faqja web

Faqja web është www.tiranait.al.

Neni 7

Posta elektronike

Posta elektronike që mund të përdoret për qëllime të komunikimit elektronik është contact@tiranait.al.

Neni 8

Kohëzgjatja

Shoqëria do të veprojë në një afat kohor të pacaktuar. Përfundimi i veprimtarisë bëhet me vendim të Bordit të Aksionerëve.

Neni 9

Qëllimi dhe Fushat e veprimtarisë

Shoqëria aspiron të realizojë aktivitetet e mëposhtme:

1. Zhvillimin e trajnimeve për formim profesional në fushën e teknologjisë së informacionit.
2. Ofrimin e zgjidhjeve të zgjuara nëpërmjet projektimit, zhvillimit dhe përmirësimit të programeve kompjuterike.
3. Kuptimin e nevojave të konsumatorëve dhe ofrimin e mundësive teknologjike, zhvillimin e sistemeve që i plotësojnë këto nevoja.



Neni 10
Data e themelimit

Shoqëria themelohet më datë 27 korrik 2023.

Neni 11
Themeluesi

Shoqëria krijohet me Aktin e Themelimit, nënshkruar me vullnetin dhe iniciativën e lirë të themelusit të saj të vetëm **Z. Denis Balla**.

Neni 12
Kapitali fillestarë

Kapitali themeltar fillestarë i shoqërisë është **100** Lekë, i përbërë nga 1 kuotë e vetme me vlerë 100 Lekë. Kapitali përbëhet 100% nga kontributi i themeluesit të vetëm të shoqërisë.

Neni 13
Organet drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Bordi i Ortakëve
2. Drejtori Ekzekutiv

Organi i vetëm vendimarrës i Tirana Institute of Technology SH.P.K. është Bordi i Ortakëve. Drejtor Ekzekutiv emërohet ortaku i vetëm **Z. Denis Balla**, i biri i Zihniut, lindur në Librazhd më 28.05.1993, banues në Tiranë.



Neni 14
Përfaqësimi ligjor

Perfaqesues ligjor i Shoqërisë është Drejtori Ekzekutiv. Nëse ai për arsye të ndryshme nuk është i disponueshëm, ia kalon këtë të drejtë një punonjësi tjetër të Shoqërisë me anë të një dokumenti të shkruar, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

Ky Akt hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 27 korrik 2023 .

Themeluesi:

Denis Balla

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'DB', enclosed within a large, loopy circular scribble.